



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 255, Datë 09.09.2026

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2026 PËR KLIENTËT
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16, 21 dhe 110, pika 4 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.09.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2668/1 prot., datë 04.09.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Gusht 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

I -Aspektet Ligjore dhe Procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 5203 prot., datë 01.09.2026, protokolluar në ERE me nr. 2668 prot., datë 03.09.2026 ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin gusht 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa e shoqërisë është shqyrtuar në përputhje me “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 110, pika 4, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas të cilit çmimi me të cilin furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon me energji elektrike përcaktohet nga ERE sipas metodologjisë së miratuar prej saj.

II – Analiza e përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin gusht 2026, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë

(ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlllogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin Gusht 2026 në vlerën 14.33 lekë/kWh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 14.33 lekë/kWh, në përputhje me përlllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (Neni 8, vendimi nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt)** për muajin Gusht 2026: **14.33 lekë/kWh;**
- **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kWh;**
- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** për klientët e lidhur në nivel tensioni 35 kV, e përcaktuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 14.04.2026, “Mbi përcaktimin e tarifave të përkohshme të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj 2026 – 31 dhjetor 2026: **1.55 lekë/kWh;**
- **Kostot administrative: 1.06 lekë/kWh;**
- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **31.07.2026 - 30.08.2026.**
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, dhe bazuar në të dhënat e paraqitura nga FSHU sh.a., si dhe në llogaritjet e kryera nga ERE, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2026, përlllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin gusht 2026			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	14.33
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.43
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSht	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSht + CA		Lekë/kWh	18.22

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton *18.22 lekë/kWh për muajin Gusht 2026*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Gusht 2026, prej 18.22 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI